



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA Durrës
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 40, datë 09.07.2026

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI I PROCESIT TË RINDËRTIMIT, SI DHE NDRYSHIMIN E NR. RENDOR 12 TË TABELËS SË MIRATUAR ME VKB-NË NR.44, DATË 23.07.2025; TË NR. RENDOR 14 TË TABELËS SË PËRCAKTUAR NË PIKËN 9 TË VKB-SË NR.104, DATË 30.03.2023; TË NR. RENDOR 250 TË TABELËS SË MIRATUAR NË ANEKSIN 1 “SUBJEKTE PËRFITUESE TË GRANTIT TË RINDËRTIMIT NJËSIA ADMINSTRATIVE ISHËM” NË VKB-NË NR.72, DATË 20.07.2020; TË NR. RENDOR 27 TË TABELËS SË MIRATUAR NË ANEKSIN 1 “SUBJEKTET PËRFITUESE NGA PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË ZONAVE TË REJA” ME VKB-NË NR. 86, DATË 29.07.2024

Në zbatim të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, Aktit Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.750, datë 27.11.2019 “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë” të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 24.12.2019, “Për përcaktimin e rregullave, të kategorive prioritare, masës së përfitimit, autoriteteve përgjegjëse dhe procedurave për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga disa programe të procesit të rindërtimit”, të ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë nr. 108, datë 12.03.2020 “Për ngritjen e Zyrës së Posaçme të Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve, Shërbimit Veterinar dhe Emergjencave Civile në Bashkinë Durrës”, i ndryshuar, Urdhërin nr.234, datë 18.08.2025, nr.9952 prot, datë 18.08.2025 “Për riformatimin e komisionit të posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit ngritur me Urdhërin nr.164 datë 26.05.2020 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit

të rindërtimit” i ndryshuar, si dhe sipas relacionit të Komisionit të Posaçëm, me propozim të Kryetares së Bashkisë,



KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e listës së subjekteve që kërkojnë të përfitojnë masën e grantit të rindërtimit, sipas Aneksit 1.
2. Miratimin e ndryshimit të nr. rendor 12 të tabelës së miratuar me VKB-në nr.44, datë 23.07.2025”, sipas Aneksit 2.
3. Miratimin e ndryshimit të nr. rendor 14 të tabelës së përcaktuar në pikën 9 të VKB-së nr.104, datë 30.03.2023”, sipas Aneksit 3.
4. Miratimin e ndryshimit të nr. rendor 250 të tabelës së miratuar në Aneksin 1 “Subjekte përfituese të grantit të rindërtimit njësi administrative Ishëm” në VKB-në nr.72, datë 20.07.2020”, sipas Aneksit 4.
5. Miratimi i ndryshimit të nr. rendor 27 të tabelës së miratuar në Aneksin 1 “Subjektet përfituese nga programi i zhvillimit të zonave të reja” me VKB-në nr. 86, datë 29.07.2024”, sipas Aneksit 5.
6. Ngarkohen për zbatimin e këtij Komisioni i Posaçëm dhe Zyra e Posaçme e Rindërtimit, Rikonstruksionit dhe Rimëkëmbjes Ekonomike pranë Drejtorisë Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETARE
Denisa Luarasi

U shpall sot me datë 10.07.2026

Aneksi 1. “Lista e subjekteve që përfitojnë masën e grantit të rindërtimit”

NR	NJESIA ADMINISTRATIVE	EMRI	ATESIA	MBIEMRI	VKB FITUESE	PËRBËRJA FAMILJARE	STRUKTURA E BANESËS	VLERA E GRANTIT
1	R1	XHIHAT	MUSTAFA	ALUSHI	NR. 74 DATE 24.07.2020	5	3+1	3,428,958
2	R2	NADIRE	DERVISH	DACI	NR. 55 DATE 26.06.2020	2	1+1	2,236,552
3	R2	ARTAN	DERVISH	HYKA	NR. 55 DATE 26.06.2020	1	1+1	2,236,552
4	R2	GJINOVEFA	SULEJMAN	XHIHANI	NR. 71 DATE 20.07.2020	1	1+1	2,236,552
5	R5	VERA	SELMAN	BERZEZI	NR. 79 DATE 29.07.2024	2	1+1	2,236,552
6	R5	ARTI	REFAT	HYSAJ	NR. 130 DATE 28.10.2021	4	2+1	2,617,558
7	R5/	NIKOLL	ISUF	PREBIBAJ	NR. 79 DATE 29.07.2024	1	1+1	2,236,552
8	R5	NIKOLA	THANAS	KOLLA	NR. 74 DATE 28.06.2021	4	2+1	2,617,558
9	RRASHBULL	RIKARDO	FERIT	RECEKU	NR. 86 DATE 31.08.2020	4	2+1	2,617,558

Aneksi 2. “Miratimin e ndryshimit të nr.rendor 12 të tabelës së miratuar me VKB-në nr.44 datë 23.07.2025”

Nr.	EMËR MBIEMËR	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET	PROGRAMI
1	Sabaje Hoxha	3	2+1	Zona e Re për Zhvillim Manëz

Aneksi 3. “Miratimin e ndryshimit të nr.rendor 14 të tabelës së përcaktuar në pikën 9 të VKB-së nr.104 datë 30.03.2023”

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHET
1	Kadime Çumani, Dhurata Çumani, Aranit Çumani, Kujtim Çumani, Rakibe Çumani	5	3+1

Aneksi 4 “Miratimin e ndryshimit të nr.rendor 250 të tabelës së miratuar në Aneksin 1 “Subjekte përfituese të grantit të rindërtimit njësisë administrative Ishëm” në VKB-në nr.72 datë 20.07.2020”



Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE
1	Katerina Pupeja, Dare Pupeja, Hill Pupeja, Pal Pupeja, Qare Pupeja, Bardhok Pupeja, Viktor Pupeja	5	3+1

Aneksi 5 “Miratimi i ndryshimit të nr.rendor 27 të tabelës së miratuar në Aneksin 1 “Subjektet përfituese nga programi i zhvillimit të zonave të reja” me VKB-në nr. 86 datë 29.07.2024”

Nr.	PRONARI	GJENDJE FAMILJARE SIPAS ÇERTIFIKATES	STRUKTURA E APARTAMENTIT QË DO PËRFITOHE	PROGRAMI
1	Gjon Gjika	5	2+1	Zona e re për Zhvillim Spitallë




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT Durrës

Nr. 537/6 prot.

Durrës, më 15 . 07 .2026

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.40 datë 09.07.2026, “Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i procesit të rindërtimit, si dhe ndryshimin e nr. rendor 12 të tabelës së miratuar me vkb-në nr.44, datë 23.07.2025; të nr. rendor 14 të tabelës së përcaktuar në pikën 9 të vkb-së nr.104, datë 30.03.2023; të nr. rendor 250 të tabelës së miratuar në aneksin 1 “Subjekte përfituese të grantit të rindërtimit Njësia Administrative Ishëm” në vkb-në nr.72, datë 20.07.2020; të nr. Rendor 27 të tabelës së miratuar në aneksin 1 “Subjektet përfituese nga programi i zhvillimit të zonave të reja” me vkb-në nr. 86, datë 29.07.2024”.

Ky vendim në bazë të Ligjit nr 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” neni 3 pika 2 nuk është akt me karakter normativ. Vendimi është akt administrativ individual bazuar në nenin 3 pika 1/a të Ligjit nr 44/2015 “Kodi e Administrative”, pasi i drejtohet subjekteve të përcaktuar individualisht duke krijuar një marrëdhënie juridike konkrete si dhe është i shteruar në zbatimin e tij.

Në bazë të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” (neni 8/a) i ndryshuar “Prefekti i qarkut verifikon ligjshmërinë e akteve me karakter normativ të organeve të vetëqeverisjes vendore”.

Për sa më sipër verifikimi i këtij vendimi duke qenë një akt administrativ me karkater individual **nuk është në kompetencën e Prefektit të Qarkut.**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ADRIAN GURRA

